



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-1742/2024

Datë:23.05.2025

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Hartës Zonale Komunale 2024-2032 Gjakovë, Ligjit Nr.04L/147 për Ujërat e Kosovës nenet 46, 50 dhe 51, UdhAdministrativ të MMPH Nr,04/2017 për kategorizimin e ndërtimeve shtojca 2, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenit 21, 22, 44 dhe 97, dhe dokumenteve të paraqitura me aplikacionit, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Gjakova” SHA në Gjakovë		
Adresa:	Rruga: “UÇK ” pn. Gjakovë		
Telefoni:	+381 390 320 997/320 503	Emaili:	info@kru-gjakova.com

Emri i Projektit:	Strukturë mbrojtëse / Argjinaturë afër lumit Erenik për mbrojtje të Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza nga përmytjet në gjatësi prej L= 517.0m’ dhe distancë D=5.0m’ nga bregu i lumit		
Emri i Projektuesit:	Investitori :KFW (Projekti i Rehabilitimit të rrjetit ekzistues të ujërave të zeza në Kosovën jug perëndimore – Faza e II-të BMZ Nr.2013 65 601)		
Adresa:			
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rruga “Megzun Boshnjaku ”pn.-Lumi Erenik Gjakovë		
Zona(t) Kadastrale: Zidi i Sadik Agës II	Nr. i parcelave kadastrale : P-70705070-00222-0	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐	Riparim ☐

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☐	Kategoria II ☒
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi: LEJOHET NDËRTIMI I OBJEKTIT TË KATEGORISË II-TË, ME DESTINIM STRUKTURË MBROJTËSE- ARGJINATURË MBROJTËSE E IMPIANTIT PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA NGA VËRSHIMET NË GJATËSI PREJ L=517.0M' DHE DISTANCË 5.0M'	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Gjakova” SHA në Gjakovë i lejohe ndërtimi i objektit të kategorisë së II-të, me destinim Strukturë mbrojtëse / Argjinaturë afër lumit Erenik për mbrojtje të Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza nga përmbytjet, në gjatësi prej L= 517.0m’ dhe distancë D=5.0m’ nga bregu i lumit, sipas Pëlqimit Ujorë të lëshuar nga MMPHI / Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent dhe MMPHI- në / Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore për ndryshimet e nevojshme dhe të kërkoj miratim për të njëjtat para zbatimit;
- Të aplikojë për Leje Ujore pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.
- Të vendose tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin për realizimin të ndërtimit;
 - pëlqimin ujor nga MMPHI;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;



A r s y e t i m

Aplikuesi: **Kompania Rajonale e Ujësjetësimit "Gjakova" SHA në Gjakovë**, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-1742/24 të datës 06.02.2024, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin Struktural mbrojtës / Argjinaturë afër lumit Erenik për mbrojtje të Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza nga përmbytjet, në parcelën kadastrale me nr. P-70705070-00222-0, ZK. Zidi i Sadik Agë II, në distancë 5.0m' nga lumi Erenik dhe gjatësi prej L=517.0m'.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, përkatësisht zyrtari përgjegjës për lëndën pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit Nr.04L/147 për Ujërat e Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën administrative, Hartës Zonale Komunale 2024-2032 Gjakovë dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë me datë 22.05.2025;
- Plani i Situacionit kopje digjitale;
- Projektin e analizës me ndërhyrje – ngritje të strukturës mbrojtëse përgjatë- në afërsi të lumit Erenik;
- Vendim - Pëlqimin Ujorë me numër pro.8314-2/25 datë 06.05.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore;
- Projektin për ekzekutim, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1 (një) CD;

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Nga një kopje të këtij vendimi ju dërgohet:

- *Parashtruesit të kërkesës,*
- *Drejtorisë për Punë Inspektuese,*
- *Arkivit.*

Udhëheqëse e Sektorit:

Elida Bejtullahu, inxh.dip.ark.